

Çfarë ndodh nëse nuk merrni asnjë përgjigje pasi keni dorëzuar formularin?

Nëse formulari nuk kthehet mbrapsht për plotësim dhe komisioni nuk kthen asnjë përgjigje apo nuk njofton se do bëjë verifikime mbi formularin, atëherë brenda 60 ditëve nga momenti i dorëzimit, vet-identifikimi do të konsiderohet i pranuar.

Çfarë ndodh nëse Komisioni njofton se vet-identifikimi i personit që i përket pakicës kombëtare nuk pranohet?

Në këtë rast Komisioni do t'ju lëshojë një dokument ku paraqitet ky vendim. Në këtë rast personi ka të drejtë të ankohet në Komisionin e Apelit të ngrihet për këtë qëllim në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Nëse sërish përgjigja e këtij komisioni nuk është në favorin e personit që kërkon të vet-identifikohet si pjesë e një pakicë kombëtare, atëherë keni të drejtë të ankoheni në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

FORMULAR I VETIDENTIFIKIMIT TË INDIVIDIT, SHTETASIT SHQIPTAR QË PRETEN- DON SE I PËRKET NJË PAKICE KOMBËTARE

PLOTËSIM I NJË FORMULARI SHEMBULL

(emër, mbiemër)

(nr. i letërnjoftimit)

(emri i babait)

(vendbanimi aktual)

(emri i nënës)

(pakica/at kombëtare, të cilës i përket)

(data e lindjes)

(gjuha/ët e pakicës/ave kombëtare, të cilës i përket)

(vendi i lindjes)

(A keni kryer ndryshime të emrit ose mbiemrit?)

(gjendja civile)

Në familje kemi folur gjuhën xx (gjuhën e pakicës) vazhdimisht, kemi festuar xx çdo xx datë bashkë me familjen dhe familjarë të tjerë. Prindërit e mi, unë si dhe shumë prej familjarëve të tjerë punojmë si xx profesion, tipik i pakicës xx, etj. (karakteristika dalluese kulturore, etnike, gjuhësore, fetare ose tradicionale, sipas nenit 3, të ligjit nr. 96/2017, "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë")

Ky udhëzues u prodhua me mbështetjen financiare të projektit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës "Fuqizimi i mbrojtjes nga diskriminimi në Shqipëri" (Instrumenti Horizontal III). Përmbajtja e saj është përgjegjësi e vetme e autorit(ëve). Pikëpamjet e shprehura në të nuk mund të merren në asnjë rast si pasqyrim i opinionit zyrtar të Bashkimit Evropian ose të Këshillit të Evropës.



Pakica kombëtare

E drejta për t'u vet-identifikuar si pjesë e një pakice kombëtare

E drejta për t'u vet-identifikuar si pjesë e një pakice kombëtare njihet si e drejtë nga ligji Nr. 96/2017 "Për mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë" për të gjithë shtetasit shqiptarë që pretendojnë se i përkasin njëres prej pakicave kombëtare të njohura në këtë ligj. Pakicat kombëtare të njohura në Shqipëri janë, greke, maqedonase, arumune, rome, egjiptiane, malazeze, boshnjake, serbe dhe bullgare. Pra, vetëm anëtarët e këtyre pakicave mund të kërkojnë të vet-identifikohen.

Procedura për vet-identifikimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare

Procedura për t'u vet-identifikuar është e thjeshtë dhe mund të bëhet nga çdokush pa ndihmë të specializuar. Procedura konsiston vetëm në plotësimin e formularit dhe dorëzimin e tij në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Kjo procedurë rregullohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr.843, datë 26.12.2024 "Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për mbledhjen e të dhënave për identifikimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare"

Formulari

Për këtë procedurë duhet të plotësohet formulari i vet-identifikimit që është pjesë e VKM-së përmendur më lart. Është e rëndësishme që ky formular t'iu shpërndahet personave pjesë e pakicave.

Ky formular kërkon disa të dhëna të thjeshta identifikimi dhe karakteristika dalluese nga personi që kërkon të vet-identifikohet si pjesë e një prej pakicave kombëtare të njohura në ligj, si psh. gjuhësore, kulturore ose fetare.

Pjesa e fundit e formularit, që ka të bëjë me karakteristikat dalluese kulturore, etnike, gjuhësore, fetare ose tradicionale të pakicës që personi pretendon se i përket, është veçanërisht e rëndësishme që jo vetëm të plotësohet, por të plotësohet me kujdes.

Këto karakteristika mund të jenë përveç gjuhës së pakicës që i përkasin, një këngë, instrument apo zakon festimi, një ditë e veçantë festimi që i përket komunitetit tuaj. Një profesion që karakterizon pakicën tuaj. Për shembull: Tradita e punimit e thurjes së kashtës, punimi i hekurit, marrja me blegtori, valle tradicionale etj

Ku do të dorëzohet formulari

Ky formular duhet të paraqitet pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme. Dorëzimi mund të bëhet personalisht në zyrat e Ministrisë së Punëve të Brendshme gjatë orarit 08:00 – 16:30 nga e hëna deri të enjten, dhe gjatë orarit 08:00–14:00 të premten, ose të dërgohet me postë në këtë Ministri në adresën 'Bulevardi Dëshmorët e Kombit Nd. 1, Tiranë 1001'. Në këtë Ministri është ngritur një Komision i cili do të shqyrtojë formularin për vet-identifikim i cili përbëhet nga përfaqësues të institucioneve qendrore dhe të shoqërisë civile.

Afatet për shqyrtimin e formularit

Brenda 30 ditëve nga depozitimi i formularit, Komisioni pranon dhe pasqyron kërkesën për vet-identifikim. Komisioni ka në përbërje dhe një person që i përket pakicës kombëtare në të cilën personi vet-identifikohet. Ky Komision nuk është i përhershëm, por ngrihet minimlaisht 2 herë në vit, ose kur kërkohet nga ¼ e anëtarëve të tij. Në raste përjashtimore, të cilat përcaktohen në VKM dhe që kanë të bëjnë me falsifikimin e të dhënave në formular, komisioni mund të vendosë të verifikojë të dhënat e paraqitura në formular. Vendimi për të bërë verifikime të mëtejshme merret me votat e 2/3 të anëtarëve të Komisionit.

Në këtë rast Komisioni ka të drejtë të:

1.kërkojë informacione shtesë mbi të dhënat në formular nga institucione të ndryshme shtetërore;

2. duhet të njoftojë për këtë vendim personin i cili kërkon të vet-identifikohet si pjesë e një pakice kombëtare;

3. procedura e verifikimit nuk mund të zgjasë më shumë se 60 ditë, nga dita kur personi është njoftuar.

Rrjedhimisht, brenda 30 ditëve Komisioni duhet të pranojë kërkesën për vet- identifikim. Nëse gjatë këtyre 30 ditëve komisioni vendos të bëjë verifikime të mëtejshme, këto verifikime nuk mund të zgjasin më shumë se 60 ditë nga dita kur personi që dëshiron të vet-identifikohet, është njoftuar ne lidhje me vendimin për verifikime të mëtejshme.

Në rast se Komisioni nuk përgjigjet brenda këtyre afateve, në lidhje me kërkesën për vet-identifikim, ajo do të konsiderohet e pranuar. Në rastin kur kërkesa nuk pranohet atëherë ky vendim mund të apelohe në një Komision Apeli që krijohet për këtë arsye. Nëse edhe ky vendim nuk është në favor të personit që kërkon të vet identifikohet, atëherë ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative.

PYETJE TË SHPESHTA

Ku mund të gjendet formulari i vet-identifikimit?

Formulari i vet-identifikimit është publikuar si pjesë e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.843, datë 26.12.2024 "Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për mbledhjen e të dhënave për identifikimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare" dhe mund të gjendet online në faqen e Qendrës së Botimeve Zyrtare. Linku Pamja e dokumentit – Qendra e Botimeve Zyrtare.

Ku duhet të dorëzohet formulari i vet-identifikimit?

Formulari i vet-identifikimit duhet të dorëzohet në Ministrinë e Punëve të Brendshme midis gjatë orarit 08:00 – 16:30 nga e hëna deri të enjten, dhe gjatë orarit 08:00–14:00 të premten ose të dërgohet me postë në këtë Ministri në adresën: Ministria e Punëve të Brendshme, 'Bulevardi Dëshmorët e Kombit Nd. 1, Tiranë 1001'. Në këtë Ministri do të jetë ngritur një Komision i cili do të shqyrtojë formularin për vet-identifikim.

Çfarë duhet patur parasysh në plotësimin e formularit?

Formulari duhet të plotësohet në tërësinë e tij, pra në çdo rubrikë. Pjesa që rezulton më komplekse për t'u plotësuar, është pyetja e fundit në lidhje me karakteristikat dalluese etnike, kulturore, gjuhësore, fetare ose tradicionale të pakicës që personi pretendon se i përket. Në këtë pjesë do duhet të përshkruhen disa veçori që i përkasin pakicës pjesë e së cilës personi kërkon të vet-identifikohet, si festat që pakica kombëtare feston, ritet që shoqërojnë këto festime, kënge apo valle të veçanta të kësaj pakice, apo profesione të veçanta që karakterizojnë këtë pakicë. Për shembull: Për shembull: Tradita e punimit e thurjes së kashtës, punimi i hekurit, marrja me blegtori, valle tradicionale etj

Çfarë ndodh nëse formulari kthehet mbrapsht për mosplotësim të saktë?

Asgjë, nuk ka afate për plotësimin e formularit, as kufizime në numër se sa herë mund të dorëzohet. Nëse formulari kthehet për plotësim, atëherë do duhet të plotësohet dhe ri-dorëzohet.